

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6381  
E shtunë, 7 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

Kuvendi nuk e miraton  
rezolutën për zbatimin  
e marrëveshjes  
së Uashingtonit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VAZHDON RITJA E RASTEVE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË | FAQE 3

## QEVERIA PARALAJMËRON MASA TË REJA KUNDËR COVIDIT



Ritja e numrit të infektiveve të reja me Covid-19 e ka shtyrë Qeverinë e Kosovës të mendojë për masa të reja të cilat kanë për qëllim parandalimin e përhapjes së pandemisë. Ministri i

Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se nga e hëna është në kontakt me të gjitha palët për masat e reja që pritet të merren në vijim. Ndërsa Oda e Hotelierisë dhe e Turizmit në Kosovë

ka njoftuar se me ministrin Vitia janë pajtuar që prej 20 gushtit qytetarët e pavaksinuar të mos lejohen të marrin pjesë në dasma, klube nate dhe aktivitete të tjera shoqërore

### OPINION

JUGOSLLAVIA PËRBALLË  
LËVIZJEVE ILEGALE  
SHQIPTARE NË KOSOVË,  
1945-1981 | F.9



Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI - BASHA

### AKTUALE



KONJUFCA DHE AMBASADORI  
NORVEGJEZ NËNSHKRUAJNË  
MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

F.7

ENVER HOXHAJ TËRHIQET  
NGA KRYESIA E PDK-SË | F.3

UP-ja HAP KONKURSIONIN PËR  
PRANIMIN E MBI 6 000  
STUDENTËVE TË RINJ | F.7

LEKAJ: AAK-ja ËSHTË  
E GATSHME PËR ZGJEDHJET  
LOKALE | F.8

### EKONOMI

KUVENDI RATIFIKON DY  
MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

F.8

MË 13 GUSHT MBAHET ANKANDI  
I 12-TË I LETRAVE ME VLERË | F.8

THELLOHET BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET UJËSJELLËSIT  
"BUSKI" TË TURQISË DHE KRU  
"PRISHTINA" | F.8

## PROFESORË, INTELEKTUALË DHE ISH-THEMELUES TË UÇK-së I BASHKOHEN PDK-SË NË KRYESINË E RE | FAQE 3



Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka zgjedhur kryesinë e re e cila përbëhet nga zyrtarë të PDK-së që janë rritur organikisht në këtë parti dhe emra të rinj që i janë bashkuar vizionit të partisë që drejtohet nga Memli Krasniqi.

Me këtë rast, Krasniqi ka thënë Kryesia e re e PDK-së përbëhet nga njerëzit e devotshëm të saj që kanë qenë në këtë parti që nga themelimi, por edhe nga gra dhe djem të rinj profesionistë që besojnë në vizionin e këtij subjekti politik

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Kalifornia vazhdon të përballet me zjarre të mëdha

**KALIFORNI, 6 GUSHT** - Kalifornia është duke përjetuar një nga zjarret më të mëdha ndonjëherë, ndërsa urdhrat për evakuim janë shtuar të enjten. Zjarri në Dixie është tashmë i gjashti më i madhi në

historinë e shtetit dhe është ende duke u përhapur falë erërave të forta.

Këtë javë flakët përfshinë tërësisht qytetin historik të minierave të Greenville. Zjarri në Dixie është vetëm një nga vërshimet e flakëve

që përfshinë shtetet e bashkuara perëndimore, që nga mesi i korrikut, pjesë e një krize klimatike të ngrohjes. Tani flakët kanë përfshirë rreth 500 kilometra katrorë. Imazhet e bëra nga një fotograf i "AFP" në

Greenville kanë treguar se si zjarri kishte shkrirë dritat e rrugës, me vetëm disa struktura ende në këmbë. Një pikë karburanti, një hotel dhe një bar janë shkatërruar si dhe shumë ndërtesa që ishin tanimë janë shkrumbuar.



## Bidenit i kërkohet ta mbyllë burgun ushtarak të Guantanamos

**WASHINGTON, 6 GUSHT** - Dhjetëra demokratë të Dhomës së Përfaqësuesve i kanë kërkuar presidentit amerikan Joe Biden që ta mbyllë menjëherë burgun ushtarak të Guantanamos në Kubë.

Disa javë para shënimit të 20-vjetorit të sulmeve të 11 shtatorit, që kanë ndikuar në hapjen e burgut, 75 ligjvënës amerikanë i kanë dërguar një letër presidentit, duke thënë se burgu vazhdon të jetë njollë për imazhin e ShBA-së, i cili dëmton përpjekjet për ta rritur zërin për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit. "Ne kërkojmë nga ju që të merrni hapat e nevojshëm për të mbyllur burgun, të veproni menjëherë ta zvogëloni popullsinë e tij dhe të siguroheni se të burgosurit e mbetur trajtohen në mënyrë njerëzore. Burgu në Guantanamo ka pasur 800 të burgosur gjatë

historisë së tij, mirëpo tani në të janë 39 burra, të plakur dhe gjithnjë e më të sëmurë", kanë shkruar ata.

Ish-presidenti amerikan George W. Bush ka hapur burgun pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në ShBA për të burgosur luftëtarët e dyshuar.

Në letër është përmendur edhe qëndrimi i Bidenit për të mbyllur këtë burg, kur është bërë nënpresident amerikan më 2009. Kur Bideni është bërë president i ShBA-së në janar të këtij viti në burg kanë qenë 40 të burgosur. Një prej tyre është liruar në shtëpinë e tij në Marok në muajin korrik.

Dhjetë të tjerëve u është pranuar kërkesa për lirim dhe janë në pritje të procedurave për riatdhesim apo zhvendosje në ndonjë shtet të tretë. Një nga të ndaluarit më të famshëm në këtë burg është i



dyshuari për organizim të sulmeve të 11 shtatorit - Khalid

Sheikh Mohammed. Në muajin shtator rasti i tij është planifikuar

të rifillojë me një seancë paraprake gjyqësore.

## Italia e bën të detyrueshme pasaportën shëndetësore për mësuesit



**ROME, 6 GUSHT** - Qeveria italiane ka njoftuar se mësuesit duhet të kenë dëshmi të vaksinimit kundër koronavirusit para se të hyjnë në klasë. Ndërkohë, "Pasaporta e Gjelbër" e vaksinimit është bërë e detyrueshme edhe për udhëtarët në trena, aeroplanë si dhe nëpër dyqane. Kjo pasaportë, qoftë digjitale, apo e printuar, tregon nëse një person ka marrë të paktën një dozë të vaksinës, ka test negativ në koronavirus apo është shëruar së fundmi nga infektimi. Me qëllim të rritjes së shkallës së vaksinimit, për ta luftuar variantin "Delta" të koronavirusit, qeveria italiane ka thënë se Pasaporta e Gjelbër do të kërkohet nëpër ambiente të brendshme të restoranteve si

dhe për një mori aktivitete të tjera.

Pavarësisht prej protestave dhe prej pakënaqësive të tjera, qeveria italiane ka zgjeruar kërkesën për pajisje me këtë pasaportë edhe për mësuesit, studentët universitarë dhe udhëtarët në distanca të gjata nga 1 shtatori.

"Zgjidhja e qeverisë është që të investojë sa më shumë që mundet në Pasaportën e Gjelbër dhe ta shmangë mbylljen", ka thënë ministri italian i Shëndetësisë, Roberto Speranza.

Mësuesit nuk do të mund të punojnë pa këtë dokument dhe pushimi më i gjatë se pesë ditë nuk do t'u paguhet.

Deri më 4 gusht rreth 65 për qind e italianëve kanë marrë të

paktën një dozë të vaksinës kundër koronavirusit, derisa 54 për qind janë të imunizuar plotësisht.

Italia është duke ndjekur hapat e Francës, e cila është kthyer në shtetin e parë evropian që ka kërkuar vaksinim për qasje në një mori ambientesh.

Ky vendim i presidentit francez Emmanuel Macron ka nxitur protesta më të mëdha sesa ato që janë parë në Itali.

Kundërshtarët e këtyre masave kanë thënë se ato janë në kundërshtim me liritë njerëzore, diskriminojnë të pavaksinuarit dhe përbuzin rregullat e Bashkimit Evropian. Gjykata Kushtetuese në Francë ka thënë më 5 gusht se pasaporta shëndetësore nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

## Autobusi përplasat me kamionin, 9 viktima dhe 30 të plagosur

**STAMBOLL, 6 GUSHT** - Nëntë persona kanë humbur jetën dhe 30 të tjerë janë plagosur pas përplasjes së një autobusi

me një kamion në autostradën Stamboll - Izmir. Aksidenti ka ndodhur pranë Manisës. Gjashtë persona humbën jetën

menjëherë pas aksidentit, ndërsa tre të tjerë nuk arritën t'u mbijetonin plagëve pas shtrimit në spital. Të paktën 30

persona janë plagosur. Sipas autoriteteve, në autobus ndodheshin 50 pasagjerë dhe tre anëtarë të ekuipazhit.





# Profesorë, intelektualë dhe ish-themelues të UÇK-së i bashkohen PDK-së në kryesinë e re

Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka zgjedhur kryesinë e re e cila përbëhet nga zyrtarë të PDK-së që janë rritur organikisht në këtë parti dhe emra të rinj që i janë bashkuar vizionit të partisë që drejtohet nga Memli Krasniqi.

Me këtë rast, Krasniqi ka thënë se kryesia e re e PDK-së përbëhet nga njerëzit e devotshëm të saj që kanë qenë në këtë parti që nga themelimi, por edhe nga gra dhe djem të rinj profesionistë që besojnë në vizionin e këtij subjekti politik

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 GUSHT - Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka zgjedhur kryesinë e re e cila përbëhet nga zyrtarë të PDK-së që janë rritur organikisht në këtë parti dhe emra të rinj që i janë bashkuar vizionit të PDK-së dhe kryetarit Memli Krasniqi.

Kryetari i ri i PDK-së, Memli Krasniqi, para anëtarëve të Këshillit Drejtues ka thënë se kryesia e re e PDK-së përbëhet nga njerëzit e devotshëm të saj që kanë qenë në PDK që nga themelimi, por edhe nga gra e djem të rinj profesionistë që besojnë në vizionin e PDK-së. "Përbëhet, po ashtu, nga njerëz që kanë qenë shumë të rinj në filltet e

saj, të identitetit të saj, të profesionalizmit dhe qeverisjes së saj, dhe të perspektivës së saj në të ardhmen", ka thënë Krasniqi.

Ai, po ashtu, ka thënë se anëtarët e Kryesisë së PDK-së nuk janë aty për kurrfarë privilegji, por për përgjegjësitë që i presin dhe, siç ka thënë ai, këto përgjegjësi janë të mëdha. "Kjo kryesi e re do të prodhojë orientimin politik të PDK-së. Do të prodhojë orientimin ideor të saj. Do të prodhojë organizimin e saj. Do të prodhojë aktivizimin e saj. Do të prodhojë alternativën e qeverisjes me Kabinetin e Qeverisjes së Mirë. Pra një kryesi e punës dhe angazhimit", ka thënë ai.

Po kush janë emrat e rinj që për herë të parë u bënë pjesë e lidhshimit të ri të PDK-së?



## Konstituohet Kryesia e re e PDK-së

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka mbajtur sot mbledhjen konstituive me anëtarët e kryesisë së re të PDK-së. Një ditë pas miratimit në Këshillin Drejtues, Kryesia e re e PDK-së ka nisur menjëherë punën dhe ndarjen e detyrave për të punuar për realizimin e programit të PDK-së dhe vizionit të kryetarit të ri, për t'i realizuar reformat për fitoret e ardhshme për PDK-në dhe Kosovën.

Lideri i opozitës, Memli Krasniqi, u dëshiroi mirëseardhje në PDK anëtarëve të rinj të kryesisë të cilët i janë bashkuar PDK-së dhe vizionit të saj si parti shtetformuese. Ai, po ashtu, ka uruar edhe anëtarët e rinj të Kryesisë së PDK-së që janë rritur politikisht në parti e që tani kanë arritur të përfaqësohen në Kryesi. Kreu i PDK-së edhe gjatë mbledhjes së kryesisë ka falënderuar të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues për besimin e dhënë për kryesinë e re, e cila, siç ka thënë ai, ka para vetes shumë punë e sfida drejt arritjes së fitores së PDK-së në zgjedhjet e ardhshme. Në këtë takim të parë të kryesisë, kryetari i PDK-së ka diskutuar edhe për përgatitjet e deritashme për zgjedhjet lokale të tetorit. Ai ka thënë se PDK-ja ka kandidatët më të mirë dhe më kredibilë për të udhëhequr komunat dhe qytetarët e Kosovës do ta vlerësojnë përkushtimin dhe angazhimin e kandidatëve të PDK-së të cilët do të ofrojnë programin më të mirë qeverisës për t'i udhëhequr komunat e Kosovës.

Edhe anëtarët e Kryesisë së re të



PDK-së e që si të rinj kanë besuar e kanë rrugëtuar me PDK-në deri sot, kur janë kalitur e janë të gatshëm për të zhvilluar betejat politike të saj. Përbëhet, po ashtu, nga njerëz që kanë përvujë në politikën e Kosovës jashtë PDK-së, të cilët tashmë janë të bindur se vetëm brenda PDK-së e me PDK-në Kosova ecën në rrugën e duhur të zhvillimit e të integritimit, përvoja e të cilëve e plotëson mozaikun tonë gjithëpërfshirës e të paalternativë. Dhe, së fundmi, përbëhet, po ashtu, nga njerëz komplet të rinj, jo veç në PDK, por edhe në politikë, të cilët janë vlerë e shtuar e që përbëjnë avantazh për ne, por që janë profesionistë e njerëz kompetentë me përvujë në fushat e tyre, të cilët sot na duhen e të cilët i kanë besuar vizionit tonë. Pra, një kryesi, që e lidh çdo hallkë të PDK-së, të përvujës së

Profesoresha e njohur e psikologjisë, Donika Shahini - Lami, është bërë pjesë e Kryesisë së PDK-së dhe anëtare e Këshillit Drejtues. Shahini-Lami më parë ka punuar për 10 vjet në Organizatën për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE). Ajo, po ashtu, njihet për punën e saj si gazetare gjatë luftës në Kosovë si dhe ka punuar për televizionin publik japonez NHK si dhe ka bashkëpunuar me media të ndryshme ndërkombëtare.

Në Kryesinë e re të PDK-së është zgjedhur edhe Jakup Nura, bashkëpunëtor i ngushtë i komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari.

Bernard Nikaj, profesor, diplomat, ish-ambasador i Kosovës në Bruksel, po ashtu i është bashkuar PDK-së në Kryesinë e re. Nikaj është i shkolluar në disa prej universiteteve më prestigjioze

botërore.

Anëtare e re e Kryesisë së PDK-së është zgjedhur edhe Besa Kabashi-Ramaj, e shkolluar në universitete amerikane dhe me përvujë mbi 10-vjeçare në fushat e sigurisë ndërkombëtare, politikat e mbrojtjes dhe menaxhmentit. Ajo ka punuar për shumë organizata e fondacione të njohura vendore e ndërkombëtare.

Pjesë e Kryesisë së re të PDK-së është bërë edhe Bekim Çollaku. Ai është i shkolluar në Britani të Madhe, me përvujë të gjatë institucionale e politike. Ai ka qenë bashkëpunëtor i afërt dhe shef stafi i kryeministrit dhe presidentit Hashim Thaçi.

Në Kryesinë e re të PDK-së është zgjedhur edhe Adri Nurellari, politolog, pedagog e publicist. Nurellari ka qenë më parë shef i kabinetit të kryetarit të PDK-së Kadri Veseli dhe këshilltar i ish-kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçi. Sekretar i përgjithshëm i PDK-së është zgjedhur Bajrush Xhemajli. Kryesia e re e PDK-së me vendim të Këshillit Drejtues do të ketë pesë nënkryetarë dhe pesë sekretari. Nënkryetarë të PDK-së janë zgjedhur Vlora Çitaku, Uran Ismaili, Ramë Buja dhe Enver Hoxhaj.

Anëtarë të tjerë të Kryesisë së PDK-së janë zgjedhur emra të njohur të PDK-së dhe zyrtarë të kësaj partie që janë rritur organikisht në PDK e ata janë: Blerand Stavileci, Nexhat Demaku, Evgeni Thaçi - Dragusha, Sokol Bashota, Rashit Çalaj, Zenun Pajaziti, Valdete Idrizi, Betim Gjoshi, Fehmi Mujota, Petrit Hajdari, Luljeta Veselaj - Gutaj, Muzafer Shala, Muhamet Haliti, Kujtim Gashi, Safete Hadergjonaj dhe Donjet Bislimi.



PDK-së e kanë falënderuar kryetarin Memli Krasniqi dhe Këshillin Drejtues për besimin e dhënë dhe mundësinë e ofruar për të dhënë kontribut në vizionin e PDK-së për të ardhmen e Kosovës.

## Enver Hoxhaj tërhiqet nga kryesia e PDK-së

Deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka njoftuar se ka vendosur që të mos jetë pjesë e Kryesisë së re të kësaj partie, ku të enjten ishte zgjedhur nënkryetar i PDK-së. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Hoxhaj ka thënë se është koha që ekipi i ri e kryesia e sapovotuar të punojë dhe të angazhohet për ta rikthyer PDK-në si forca e parë politike. "Faleminderit kryetarit Krasniqi dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të PDK-së për besimin e dhënë që të jem pjesë e kryesisë së re të partisë dhe një nga nënkryetarët e saj. Me të drejtë u diskutua dhe sot nëse po shmangej me përfshirjen time një parim i vendosur që deputetët të mos përfshihen në kryesinë e re", ka shkruar Hoxhaj.

Hoxhaj ka thënë se pavarësisht se është tërhequr nga kryesia, do të ndihmojë partinë dhe kandidatët e saj në zgjedhjet lokale. "Në vijimësi të qëndrimit të shprehur edhe në Konventën e zgjedhjes së kryetarit të ri që PDK ka nevojë të hapet, të afrojmë njerëz të rinj dhe të reformohet, unë do ta respektoj këtë parim dhe do të mbetem vetëm deputet. Është koha që ekipi i ri e kryesia e sapo votuar të punojë dhe angazhohet për ta rikthyer PDK-në si forca e parë politike. Do të angazhohem me tërë qenien time për ta ndihmuar partinë si dhe kandidatët tanë në zgjedhjet lokale", ka shkruar Hoxhaj.

Detyrën e anëtares së kryesisë së PDK-së nuk e ka pranuar as Donika Shahini - Lami e cila ka thënë se nuk do ta vazhdojë këtë rrugëtim. Pas këtij veprimi, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka falënderuar deputetin Enver Hoxhaj i cili ka vendosur ta respektojë parimin e Konventës së PDK-së që deputetët mos të mbajnë pozita të dyfishta, duke qenë edhe anëtarë të kryesisë. "E falënderoj shumë për këtë qasje pozitive të tij dhe për ofrimin e gjithë mbështetjes që ka dhënë dhe do të japë për reformat dhe fitoret e PDK-së për Kosovën", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook". Të premtën është larguar nga PDK-ja edhe Migjen Kelmendi, i cili ishte bërë pjesë e PDK-së gjatë kohës kur këtë parti e drejtonte Kadri Veseli.



VAZHDON RITJA E RASTEVE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË

# Qeveria paralajmëron masa të reja kundër Covidit



Rritja e numrit të infektiveve të reja me Covid-19 e ka shtyrë Qeverinë e Kosovës të mendojë për masa të reja të cilat kanë për qëllim parandalimin e përhapjes së pandemisë. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se nga e hëna është në kontakt me të gjitha palët për masat e reja që pritet të merren në vijim. Ndërsa Oda e Hotelierisë dhe Turizmit në Kosovë ka njoftuar se me ministrin Vitia janë pajtuar që prej 20 gushtit qytetarët e pavaksinuar të mos lejohen të marrin pjesë në dasma, klube nate dhe aktivitete të tjera shoqërore

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se janë duke e shqyrtuar mundësinë e vendosjes së masave të reja për të parandaluar përhapjen e pandemisë. Duke folur për situatën e fundit të krijuar pas rritjes së rasteve me Covid-19, para deputetëve Vitia ka thënë se që nga e hëna është në kontakt me të gjithë aktorët për masat e reja që pritet të merren në vijim. Ai u ka bërë thirrje edhe një herë të gjithë qytetarëve që të vaksinohen.

“Nga e hëna jemi në kontakte për masat e reja. Tanimë ka vaksina mjaftueshëm dhe nuk ka asnjë arsye që qytetarët të mos vaksinohen. Virusi ‘Delta’ nuk kursen as fëmijët, janë shumë fëmijë të infektuar dhe ky është një alarm për të gjithë qytetarët që të jenë të ndërgjegjshëm”, ka thënë ai. Vitia ka paralajmëruar se mund të merren masa të veçanta për të vaksinuarit dhe ata që nuk e kanë bërë deri tash një gjë e tillë. “Vaksinat janë të sigurta, terminë ka mjaftueshëm, prandaj u bëj lutje qytetarëve të vaksinohen. Do të

ndërmarrim masa për qytetarët që s’janë vaksinuar”, ka thënë ai. Edhe shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrë masa të reja për përballimin e situatës me Covid. Ai ka shtuar se shtimi i numrit të rasteve me Covid-19 është alarmant. “I bëj thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndërmarrë masa të reja për krijimin e kësaj situatë të re që tashmë po ballafaqohemi që disa ditë. Rritja e numrit të rasteve me Covid në tri ditët e

fundit do të thotë që Kosovën nuk e presin edhe aq ditë të mira në ballafaqimin me pandeminë Covid-19. Si parti opozitare në Kuvendin e Kosovës kërkojmë nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë masa për organizimin e mësimit online në rast se do të jetë e nevojshme nga shtatori e tutje. Pra, besojmë se tashmë qeveria duhet të jetë më e përgatitur dhe të ketë marrë mësime nga viti i kaluar dhe në momentin që do të jetë e nevojshme mbyllja e shkollave, atëherë nuk duhet t’i kemi humbjet që i kemi pasur në mësime si vitin e kaluar”, ka thënë Tahiri.

## Brenda 24 orëve të fundit 271 raste të reja me Covid

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 271 raste të reja me Covid.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 15 qytetarë të cilët kanë qenë të infektuar me Covid. “Nga 4 666 testime, 271 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 15 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 719. Në total numri i rasteve aktive është 1 321”, ka njoftuar MSh-ja. Po kjo ministri ka treguar edhe për numrin e qytetarëve të vaksinuar. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 8 188 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 478 084 doza të vaksinës. Deri më sot 165 190 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 4 666 testime, 271 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19”, ka treguar ministria. Instituti Kombëtar i



## NAGAVCI SËRISH BËN THIRRJE PËR VAKSINIM TË MËSIMDHËNËSVE

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI), Arbërie Nagavci, edhe të premten u ka bërë thirrje të gjithë punëtorëve arsimorë që të vaksinohen kundër Covid-19 para nisjes së vitit të ri shkollor. Në një konferencë për media ajo ka thënë të premten se studimet kanë treguar se mësimi online dhe ai i kombinuar nuk kanë treguar rezultatet e duhura. "Jemi duke i marrë të gjitha masat që viti i ri shkollor të nisë me

prani fizike në shkolla", ka thënë ajo në një konferencë për media. Sipas Nagavcit, deri më tani rreth 50 për qind e të gjithë personelit në institucionet e arsimit është vaksinuar. "Po synojmë që t'i kemi të gjithë mësimdhënësit dhe stafin tjetër të vaksinuar. Bëj thirrje për të gjithë punëtorët e arsimit, mësimdhënësit dhe personelin tjetër, që të vaksinohen dhe të jenë të gatshëm për vitin e ri shkollor", ka deklaruar ajo.

Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) përsëri të premten u ka bërë thirrje qytetarëve që të marrin vaksinën kundër Covidit. Përmes një njoftimi për media, IKShPK-ja ka vlerësuar se vaksinimi është metoda më

e mirë dhe më efektive në luftën kundër Covid-19! "Vaksinimi është metoda më e mirë, më e lirë dhe më efektive në luftën kundër Covid-19! Vaksinimi zgjon mbrojtjen natyrore të trupit tonë për të krijuar rezistencë ndaj

infeksioneve specifike dhe e fuqizon sistemin imunitar! Vaksinimi parandalon vdekjet dhe komplikimet e rënda të cilat kërkojnë shtrirjen e pacientit në spital. Vaksinohuni tash për të mos marrë masa rigorozë në vjeshtë!", ka bërë

me dije IKShPK-ja. Numri i rasteve ka filluar të rritet në pjesën e dytë të muajit korrik, kur janë liruara pothuajse të gjitha masat kundër Covidit. Derisa në pjesën e parë të muajit korrik numri ditore

rasteve të infektimit ishte njëshifror, në pjesën e dytë të muajit rastet kishin filluar të dyfishohen. Më 17 korrik në total numri i rasteve aktive në Kosovë kishte rënë nën 100, kurse tani numri total i rasteve aktive është 1 321.

## OHT-ja: Nga 20 gushti s'mund të shkoni në dasma pa qenë të vaksinuar

Oda e Hotelierisë dhe Turizmit (OHT) në Kosovë ka bërë me dije se shumë shpejt pritet të hyjnë në fuqi disa masa kufizuese për ata që nuk dëshirojnë të vaksinohen me vaksinat kundër Covidit. OHT-ja ka treguar se me ministrin Vitia janë pajtuar që çdo qytetar i Kosovës në mënyrë që të marrë pjesë në ndonjë aktivitet shoqëror, qoftë qendër tregtare, klube të natës apo në ahengjet familjare, obligohet që ta marrë vaksinën anti-Covid. "Drejtori i Departamentit të Sallave të Dasmave pranë Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të

Kosovës, z. Driton Hoti, ka mbajtur sot një takim me ministrin e shëndetësisë, z. Arben Vitia. Takimi ishte për qëllim të diskutimit rreth ngritjes së rasteve të të infektuarve me Covid-19 dhe nga ky takim u vendos të merret një vendim. Çdo qytetar i Kosovës në mënyrë që të marrë pjesë në çdo aktivitet shoqërorë, qoftë qendër tregtare, klube të natës apo në ahengjet familjare obligohet që të marrë vaksinën anti-Covid, sepse nga data 20 gusht do të kërkohej që të paktën dozën e parë ta kenë të përfunduar, përndryshe nuk mund të

marrin pjesë në asnjë aktivitet", është thënë në njoftimin e OHT-së.

Sipas kësaj ode, me ministrin Vitia janë pajtuar edhe për zgjatje të orarit për klubet e natës. "Sa i përket stafit punues të këtyre sektorëve, obligohen që deri më 12 gusht të përfundojnë të paktën dozën e parë të vaksinimit. Gjithashtu, sa i përket orarit të klubeve të natës, u bisedua që të ketë zgjatje, pra këto aktivitete të fillojnë nga ora 23:00 deri në orën 03:00 pas mesnate. Këto vendime priten të hyjnë në fuqi më 11.08.2021", është thënë në njoftim.

## Kuvendi nuk e miraton rezolutën për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit

PRISHTINË, 6 GUSHT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar që të miratojnë një rezolutë për zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit të arritur më 4 shtator 2020 në Shtëpinë e Bardhë. Për rezolutën e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë votuar 24 deputetë, ndërsa 57 kanë abstenuar. Ishin deputetët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ata që kanë abstenuar për miratimin e kësaj rezolute, ndërkaq në sallë ishin 83 deputetë.

Rezoluta ftonte Qeverinë e Kosovës të zbatonte këtë marrëveshje dhe të përgatiste një plan veprimi që do t'i dorëzohet Kuvendit. Debatimi për këtë rezolutë ishte zhvilluar më 7 korrik.

Shtetet e Bashkuara kanë deklaruar që presin nga Kosova dhe Serbia t'u përmbahen detyrimeve që dalin nga marrëveshja e Uashingtonit. Përndryshe, rezolutat e miratuara nga Kuvendi nuk janë detyruese, por pasqyrojnë vullnetin politik. Mosvotimi i rezolutës për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit nuk duhet të shihet si mosvlerësim i rolit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka thënë për "Radion Evropë e Lirë", shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila. Sipas saj, Lëvizja Vetëvendosje

kundërshton nismën e 'mini-Shengenit' dhe ndarjen e resurseve me Serbinë për liqenin e Ujmanit. "Janë dy parime përmbajtësore. E para është që në asnjë mënyrë ose në asnjë formë mosmbështetja e kësaj rezolute sot nuk lidhet me mosvlerësimin e rolit të ShBA-së, e kundërta. Si grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Qeveria e Kosovës mbeten të përkushtuara për një partneritet strategjik, i cili është i veçantë për Kosovën dhe popullin e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne do ta vazhdojmë bashkëpunimin në të gjitha sferat në veçanti edhe në raport me procesin e dialogut. Parimi tjetër është që Kosova në dialog nuk hyn si palë e cila duhet të konsiderojë se duhet të vazhdojë të bëjë kompromise të mëtutjeshme, por si dy shtete që do të diskutojnë për një të kaluar, ku Serbia ishte agresorja dhe Kosova viktima", ka thënë Kusari-Lila.

Në marrëveshjen e arritur në Shtëpinë e Bardhë parashihet edhe studimi i fizibilitetit për liqenin e Ujmanit, që shtrihet në territorin e Kosovës dhe të Serbisë. ShBA-ja prezantoi më 23 qershor studimin e fizibilitetit për menaxhimin e burimeve ujore të këtij liqeni, ku u tha se çështja e Ujmanit të rregullohet sipas traktatit të lumit Kolumbia.



Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë seancës kur është debatuar për rezolutën, ka thënë se liqeni i Ujmanit është i Kosovës. "Liqeni i Ujmanit, liqe artificial nga Kosova, i Kosovës. Ne do t'i përdorim të gjitha argumentet në këtë studim të fizibilitetit të publikuar së fundmi, për ta mbrojtur këtë pasuri të Kosovës nga çfarëdo pretendimi", kishte deklaruar Kurti. Sipas Kurtit, efekti i parë i marrëveshjes së Uashingtonit ishte në të mirë të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Efekti i menjëhershëm nuk kishte qenë ajo që ndodhi pas nënshkrimit, ajo që i parapriu nënshkrimit, e kjo është hapja e portës së Shtëpisë së Bardhë për presidentin e Serbisë", pati deklaruar Kurti më 7 korrik. Marrëveshja e Uashingtonit për normalizimin e raporteve ekonomike, ndër të tjera, parasheh

angazhimin e Kosovës dhe të Serbisë për ndërtimin e lidhjeve rrugore dhe hekurudhore, për t'i lidhur kryeqytetet e tyre në mënyrë që ta përmirësojnë lëvizjen e mallrave dhe njerëzve, zhvillime këto që mund të tërheqin investime perëndimore. Sipas marrëveshjes, Kosova zotohet të bëhet pjesë e nismës së "mini-Shengenit" apo, siç njihet tani me termin "Ballkani i hapur", që parasheh lëvizjen pa pasaporta dhe detyrime tarifore në vendet e Ballkanit. Në këtë nismë bëjnë pjesë Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

Për këtë iniciativë është shprehur kundër kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Qeveria e tij ka thënë se kjo nismë është pa vizion dhe është parë si "ide e rrezikshme" pasi, sipas ekzekutivit, krijohet përshtypja se ekziston alternativë për integrimin në BE.

Por, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'u qaset me "mendje të hapur" përpjekjeve për integrim rajonal ekonomik. "Në fund të fundit, Qeveria e Kosovës duhet të vendosë se në cilat iniciativa do të bashkohet dhe cilat e mbështetin më së miri vizionin e saj ekonomik. Megjithatë, ne e inkurajojmë qeverinë që t'u qaset përpjekjeve për integrim rajonal ekonomik me mendje të hapur dhe të përqafojë zgjidhjet që japin rezultate për kosovarët që përmirësojnë raportet me fqinjët e saj", ka thënë për "Rel" një zëdhënës i Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Në kuadër të marrëveshjes së Uashingtonit ishte edhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis Izraelit dhe Kosovës. Më 1 shkurt, përmes një ceremonie virtuale, Kosova dhe Izraeli vendosën marrëdhënie diplomatike, ndërsa më 14 mars Kosova përmbushi obligimin nga Marrëveshja e Uashingtonit, duke hapur ambasadën e saj në Jerusalem.

Marrëveshja e Uashingtonit u nënshkrua nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në prani të presidentit të atëhershëm amerikan Donald Trump.





## Kamenica nis fushatë për parandalimin e zjarreve

**KAMENICË, 6 GUSHT (ER)** - Komandanti i Stacionit Policor në Kamenicë, Florim Klaiqi dhe njësitet sektoriale të policisë, së bashku me inspektorin komunal për parandalimin e zjarreve, Naser Vllasin, kanë vazhduar fushatën vetëdijesuese për parandalimin e zjarreve. Ata kanë takuar edhe kryetarin e Bashkësisë Islame në Kamenicë për ta njoftuar me këtë fushatë, si dhe kanë kërkuar t'u bashkëngjiten kësaj nisme. Kryeimami në Komunën e Kamenicës ka theksuar se

ligjërata e parë e para faljes së xhumasë do t'i kushtohet thirrjes për parandalimin e zjarreve. Policia dhe inspektorati takimet i kanë vazhduar edhe me anëtarët e KLSP-ve, hoxhallarë e sigurisht dhe drejtpërdrejt me banorë nga lokalitete të ndryshme. Mes të tjerash, ata u kanë sqaruar se kushdo që ndez zjarre qëllimshëm, apo edhe nga pakujdesia, përgjegjësia është e njëjtë dhe do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

## Përfshihet nga zjarri aneksi i një shtëpie në Junik

Komuna e Junikut ka bërë me dije se një ankes i një shtëpie në lagjen "Agim Ramadani" në Junik është përfshirë nga zjarri. Sipas kësaj komunë, falë intervenimit të shpejtë profesional dhe vetëmohues të zjarrfikëseve dhe policisë së Junikut është parandaluar

përfshirja nga zjarri dhe djegia e shtëpisë. "Evakuimi i banorëve është bërë me kohë, duke mos u rrezikuar jeta e tyre. Urojmë të mos kemi më raste të tilla", ka njoftuar Komuna e Junikut, e cila drejtohet nga Agron Kuçi.



## QKMF-ja e Gjakovës pranon një autoambulancë nga MSh-ja



**GIKOVË, 6 GUSHT (ER)** - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjakovë ka pranuar një automjet të ndihmës së shpejtë nga Ministria e Shëndetësisë (MSh), i blerë nga huamarrja e Bankës Botërore dhe e prokuruar nga UNOPS (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime dhe Projekte). Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Gjakovës, Flamur Fetahaj, është shprehur mirënjohës për këtë donacion, duke thënë se një automjet si ky do të ndihmojë në avancimin e shërbimeve emergjente shëndetësore dhe do ta lehtësojë transportin e pacientëve nga niveli parësor i kujdesit shëndetësor në nivelet e tjera. Falënderues janë shprehur edhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Afërdita Spahiu-Shllaku, ushtruesi i detyrës i drejtorit të QKMF-së, Arben Koshi, zyrtarë komunalë dhe stafi shëndetësor i kësaj qendre.

## Komuna e Mitrovicës të dielën organizon aktivitetin "Dita e Mërgimtarëve"

**MITROVICË, 6 GUSHT (ER)** - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të dielën, më 8 gusht, me fillim nga ora 13:00, do të

mbahet aktiviteti "Dita e Mërgimtarëve" në Shalë të Bajgorës. "Në këtë aktivitet, i cili tashmë është bërë tradicional, do të gërshetohen aktivitete të

shumta kulturore, artistike si dhe për të pranishmit do të shfaqet një koncert i pasur artistik", ka njoftuar komuna e Mitrovicës.





## UP-ja hap konkursin për pranimin e mbi 6 000 studentëve

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka hapur të premtën konkursin për pranimin e studentëve të ri në nivelin bachelor përviti akademik 2021-22. Në këtë vit të studimeve UP-ja do të pranojë 6247 studentë të rregullt. Afati për aplikim online do të zgjasë deri më 24 gusht, teksa

afati për dorëzimin e dokumentacionit fizik do të bëhet nga 25 deri më 28 gusht 2021. "UP-ja në vitin e parë të studimeve themelore, në afatin e parë të konkursit për këtë vit akademik, do të regjistrojë 6 247 studentë të rregullt. Aplikimi online nis nga sot, më 06.08.2021 dhe zgjat deri më

24.08.2021 në orën 16.00. Ndërkaq, dorëzimi i dokumentacionit fizik, vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online, do të bëhet prej datës 25.08.2021 deri më 28.08.2021. Konkursi është publikuar në uebfaqen zyrtare dhe në platformat e tjera të UP-së", ka njoftuar UP-ja.

Edhe Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan të premtën ka hapur konkursin për pranimin e studentëve për vitin akademik 2021/2022. Aplikimi do të bëhet online dhe është i hapur nga 6 gusht deri më 24 gusht në orën 16:00. Sipas këtij universiteti, në afatin e parë të konkursit do të




pranohen 725 studentë, ndërsa provimi pranues do të mbahet më 31 gusht dhe 1 shtator.

## Konjufca dhe ambasadori norvegjez nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kuvendi i Kosovës dhe Ambasada e Norvegjisë në Prishtinë kanë nënshkruar të premtën memorandumin e mirëkuptimit: "Mbështetje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, kryetarin e Kuvendit dhe kabinetin e tij, komisionet dhe grupet parlamentare, nën kornizën fuqizimi i paqes dhe shtetndërtimit dhe avancimi i agjendës evropiane të Kosovës". Memorandumin e kanë nënshkruar kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ambasadori norvegjez në Kosovë, Jens Erik Grondahl dhe drejtori ekzekutiv i Grupit Ballkanik për Hulumtim të Politikave, Naim Rashiti. Nëpërmjet këtij memorandumit palët do të angazhohen të bashkëpunojnë dhe të pranojnë nevojën për ta avancuar

agjendën e Kosovës për në BE dhe reformat, duke rritur kapacitetet legislative dhe mbikëqyrëse të Kuvendit. Po ashtu, palët janë pajtuar të hyjnë në bashkëpunim i cili do të përfshijë mbështetjen për Kuvendin e Republikës së Kosovës për rekrutimin e ekspertëve për ta mbështetur kryetarin e Kuvendit, por edhe komisionet dhe grupet parlamentare në fushën e dialogut, ligjbërjes, bashkëpunimit rajonal si dhe të llogaridhënies dhe transparencës së qeverisë e të institucioneve të tjera publike, të cilat i raportojnë Kuvendit. Ndër të tjera, memorandumit parasheh sigurimin e kapaciteteve për zhvillim në fushën e politikave të sigurisë dhe infrastrukturës kibernetike (softueri dhe hardueri).



## Lekaj: AAK-ja është e gatshme për zgjedhje lokale



PRISHTINË, 6 GUSHT - Deputeti nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se kanë analizuar dobësitë e tyre gjatë zgjedhjeve të përgjithshme dhe se tashmë janë të gatshëm për zgjedhjet lokale. "Pas zgjedhjeve të përgjithshme ne menjëherë iu kemi qasur zgjedhjeve lokale, kemi analizuar gjendjen dhe kemi parë dobësitë se ku nuk kemi dalë mirë në zgjedhjet e përgjithshme. Ne jemi në terren tërë ditën dhe mendoj se jemi më të përgatitur si

asnjëherë më parë që të dalim fitimtarë dhe të jemi të parët", ka thënë Lekaj. Më tutje, ai ka thënë se janë të parët sa i përket disa prej komunave, duke theksuar se pretendojnë të marrin një pjesë të konsiderueshme të tyre në zgjedhjet lokale. "Kur them se jemi të parët nëpër komuna, është se ne kemi qenë me shtatë komuna më parë e tash jemi me gjashtë komuna pasi kryetari i Obiliqit është larguar, por ne pretendojmë edhe komuna të tjera si Peja,

Istogu, Prishtina, Podujeva e që janë shumë kandidatë atraktivë", ka thënë Lekaj për "EO". Lekaj ka thënë se për kryetar të Prishtinës kanë një kandidat profesionist dhe më të devotshmin, duke shtuar se Prishtina do t'i sjellë fitore kësaj partie. "Mendoj që Prishtinës ia kemi ofruar njeriun më të devotshëm, më punëtorin, më profesionistin, që ka dëshmuar se e do Kosovën dhe që qytetarët e kanë një zgjedhje të shkëlqyer për Prishtinën", ka thënë Lekaj.

## Zeinah Salahi jep betimin si drejtoreshë e re e USAID-it në Kosovë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Zeinah Salahi është betuar si drejtoreshë e Misionit të USAID-it në Kosovë, në një ceremoni të drejtuar nga administratori i USAID-it, Samanta Power. Në ceremoninë virtuale ka marrë pjesë edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Phillip S. Kosnett. Ambasadori Kosnett ka folur për kontributin e Salahiut gjatë qëndrimit

të saj në Kosovë si zëvendës drejtoreshë e misionit dhe ka folur për rolin e USAID-it në zhvillimin e Kosovës. Ai ka thënë se nën udhëheqjen e Zeinah Salahi sheh një të ardhme të ndritur për USAID-in në Kosovë. USAID-i promovon dhe demonstroi vlera demokratike jashtë vendit dhe avancoi një botë të lirë, paqësore dhe të begatë. Objektivi i USAID-

it është t'i mbështesë partnerët që të bëhen të pavarur dhe të aftë për t'i udhëhequr udhëtimet e tyre të zhvillimit, duke zvogëluar shtrirjen e konfliktit, duke parandaluar përhapjen e sëmundjeve pandemike dhe duke kundërshtuar nxitësit e dhunës, paqëndrueshmërisë, krimit ndërkombëtar dhe kërcënimeve të tjera të sigurisë.





## Më 13 gusht mbahet ankandi i 12-të i letrave me vlerë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 13 gusht 2021 do të mbahet ankandi i 12-të i letrave me vlerë për vitin 2021. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën

prej 25 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen 3 vjet dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për

detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit të kontaktojnë ndonjëherë nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



# Thellohet bashkëpunimi ndërmjet ujësjellësit 'Buski' të Turqisë dhe KRU 'Prishtina'

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" të premtën e ka vizituar një delegacion nga Turqia, respektivisht zyrtarët më të lartë të ujësjellësit të Bursës "Buski". Në këtë vizitë ata janë pajtuar për thellimin bashkëpunimit me KRU "Prishtina" pas takimit që kishin edhe vitin e kaluar. Vizitën e tyre në KRU "Prishtina" e kanë mirëpritur kryeshefi ekzekutiv Sokol Xhafa, zyrtarët e lartë dhe menaxherët e kësaj kompanie. Ata sërish janë njoftuar për së afërmi me gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit, ujërave të zeza, furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm për komunat në të cilat ofrojmë shërbime, projektet specifike zhvillimore, sfidat dhe vështirësitë me të cilat po përballet KRU "Prishtina" etj. "Qëllimi i kësaj vizite kishte për fokus ngritjen e kapaciteteve me mbështetje profesionale nga ana

e tyre, luftimi/reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit dhe optimizimi i proceseve të trajtimit të ujit, makineria që shfrytëzohet për reduktimin preciz të humbjeve të ujit etj. Ata, po ashtu, vazhduan të na mbështetin për ofrimin e bashkëpunimit për shkëmbim informacionesh dhe përvojash në të mirë të zgjidhjes afatgjate, furnizim të qëndrueshëm me ujë. Pas përfundimit të vizitës në ujësjellës ata vizituan edhe Ministrinë e Ekonomisë të cilët u mirëpritën nga drejtori i njesisë për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, Besim Imeri, bashkë me stafin e tij. Vizitat e tyre u realizuan edhe në impiantet e trajtimit të ujit, prej të cilave furnizohen me ujë të pijshëm pjesa dërrmuese e konsumatorëve. Vizitën e realizuan dy zëvendës drejtorë të ujësjellësit të Bursës 'Buski', Ibrahim Yedikardes dhe Mesut Boz, me stafin e tyre përcjellës",



është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina". KRU "Prishtina" ofron shërbime

për ujësjellës dhe kanalizim në 40 për qind të territorit të Republikës së Kosovës, në gjithsej 8 komuna

si: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Shtime, Graçanicë, Lipjan, Podujevë dhe Drenas.

## Kuvendi ratifikon dy marrëveshje ndërkombëtare



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ratifikuar të premtën dy marrëveshje ndërkombëtare. Bëhet fjalë për Marrëveshjen bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim "KSV/017: Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II)" dhe Projektligji nr. 08/L-009 për ratifikimin e amendamentimit nr. 1 të Marrëveshjes kornizë së kredisë të datës 14 gusht 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës, e

përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, për financimin e projektit "Reagimi Emergjent ndaj Covid-19". Votimi i këtyre marrëveshjeve është mbështetur nga Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, komuniteti multietnik dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ndërkohë subjektet politike nuk kanë gjetur pajtueshmëri për të votuar edhe dy marrëveshje të

tjera ndërkombëtare: Projektligjin nr. 08/L-006 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Investime (BEI), për financimin e Projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 dhe Projektligjin nr. 08/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim për zbatimin e Projektit "Hulumtimi dhe shkencat e aplikuar në arsimin e lartë + (HERAS+).

## Kuvendi emëron bordin e ri të AKP-së

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të

Privatizimit (AKP). Me 60 vota për dhe një abstenim Nazmi Mikollovci është emëruar kryesues i bordit të AKP-së, ndërsa anëtarë janë emëruar: Suzana Dautaj Surdulli, Mentor Hyseni, Vjollca Jashari, Violeta Arifi Krasniqi,

Xhevdet Neziraj, Halim Muqolli dhe Avni Ajdini. Mandati i anëtarëve të bordit të AKP-së do të jetë katërvjeçar. Kundër propozim-vendimit të qeverisë janë deklaruar deputetët e partive opozitare.





# JUGOSLLAVIA PËRBALLË LËVIZJEVE ILEGALE SHQIPTARE NË KOSOVË, 1945-1981



Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA

Që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit në botën shqiptare ekzistonte një program kombëtar i ruajtjes së tërësisë tokësore të atdheut dhe i bashkimit kombëtar, mbi bazën e të cilit ishin hartuar gjithë programet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vijim. Ky qëllim programor i Lëvizjes Kombëtare mbeti i pandryshuar në thelb, sepse buronte nga e drejta legjitime dhe e natyrshme e tyre për të qenë të barabartë me popujt e tjerë.

Menjëherë pas Kuvendit të Prizrenit më 1945, në ilegalitet të thellë filluan të vepronin organizatat e shumta patriotike ilegale shqiptare, si: Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare, Besa Kombëtare dhe disa të tjera pak më të vogla. Veprimtaria patriotike ilegale në Kosovë nuk ishte diçka e re, ajo ishte vazhdimësi e lëvizjeve të mëhershme patriotike të cilat ishin përpjekur që taktikën dhe strategjinë e vet, si dhe platformën ideo-politike t'ua përshtatin rrethanave aktuale, lëvizjeve politike dhe ngjarjeve në vend e në botë, në mënyrë që të kishin sukses dhe jehonë më të madhe për realizimin e qëllimeve të tyre. Lëvizja patriotike shqiptare ilegale në Kosovë kishte një shtrirje të madhe në kohë dhe në hapësirë, që përfshinte vitet 1945-1998, me aktivitete dhe me problematikë të larmishme, me momente kulmore dhe herë-herë shpërthyes, që dilte nga suazat e ilegalitetit, si në vitet 1968, 1981, 1989 dhe në fund më 1997-1999, kur iu vu ballë për ballë regjimit të Beogradit.

Në një dokument "Top sekret", të Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Kosovës dhe të Sekretariatit Republikan të Punëve të Brendshme të Serbisë, me numër 4000/1, tetor 1986, bëhej analiza e shkaqeve dhe e burimeve të ripërtëritjes së organizimit ilegal të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Duke iu referuar dokumentit, shihet qartë se aktiviteti ilegal i shqiptarëve kishte filluar t'i nixte organet e punëve të brendshme të bënin analiza që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, domethënë që nga viti 1945, kur Kosovën me tradhti e

kishte aneksuar Serbia. Në bazë të dokumentit, konstatojmë se populli shqiptarë edhe si individ por edhe si kolektivitet përcilleshin, përgjoheshin dhe anashkaloheshin me qëllime të caktuara.

Sipas një rekapitulimi të UDB-së më 1947, në Kosovë nga viti 1945-1947, vepronin rreth 55 grupe të armatosura të udhëhequra nga një elitë patriotësh, që përfshinte një numër prej 60 vetash. Ata, ishin persona me autoritet dhe gëzonin respektin e masave të gjëra. Këto 55 grupe, rreth vetes grumbullonin më tepër se 1.375 veta të armatosur. Mirëpo efektivin e luftëtarëve më të pa kompromis kundër pushtetit jugosllav e përbënin 375 veta. Po gjatë kësaj periudhe, sipas një dokumenti të botuar, që na i sjell hulumtuesi i palodhur, prof. dr. Qerim Lita, organet e ndjekjes arrestuan 356 veta. Të gjithë të arrestuarve iu shqiptuan 1. 227 vjet burg dhe 38 veta u dënuan me pushkatim. Edhe pse u zbuluan dhe u dënuan shumë anëtarë të organizatave, megjithatë, shumica e anëtarëve mbeti e pa zbuluar dhe në vitet në vazhdim zhvilluan aktivitet të dendur ilegal në organizata të ndryshme, të cilat ishin vazhdimësi e "Komitetit Nacional Demokratik Shqiptarë", por me emra të tjerë.

Pastaj llogaritet se vetëm në periudhën 1947-1960 nga ana e organeve të ndjekjes të Jugosllavisë në Kosovë janë zbuluar 69 grupe e organizata ilegale me mbi 600 anëtarë. Gjatë kësaj periudhe janë arrestuar mbi 420 vetë, ndërsa janë dënuar 250 anëtarë. Me zbulimin e këtyre organizatave dhe me arrestimin e disa anëtarëve të tyre, nuk do të thotë se edhe aktiviteti i tyre patriotike do të shuhej. Përkundrazi, dita më ditë veprimtaria patriotike masivizohej dhe në rrjetin e saj hynte inteligjenca e mirëfilltë shqiptare. Aktiviteti i këtyre organizatave kishte vazhduar deri më 1968, kur edhe e tërë puna e tyre kurorëzohet me sukses, me daljen e studentëve në demonstratat. Mu këtu edhe lind kërkesa popullore "Kosova-Republikë" dhe kërkesa për vetëvendosje. Veprimtarin patriotike të këtyre grupeve në këtë periudhë, posaçërisht gjatë viteve 1979-1980, e karakterizojnë përpjekjet e tyre për ndërlidhjen aksionale dhe lidhshmërinë organizative, masivizimin, ngritjen dhe aftësimin ideopolitik të anëtarëve nëpërmjet leximit të literaturës patriotike, kryesisht të marra nga shteti amë-Shqipëria. Gjatë kësaj periudhe aktiviteti më i dendur që u zhvillua në

organizatat ilegale ishte realizimi i shkrimit dhe shpërndarja e flet-thirrjeve për të punuar për çështjen dhe lirin e Kosovës nga robëria.

Sipas të dhënave të organeve të SPB-së të Kosovës, në periudhën 1974-1981, kundër 140 personave është ngritur aktakuza penale, prej tyre janë dënuar 89 persona në kohëzgjatje prej 1-15 vjet burgim të rëndë, 40 veta janë dënuar me kundërvajtje, 453 personave i është tërhequr vërejtja për veprimtari ilegale, kurse për 51 veta është ndërprerë aktakuza për shkak të rrethanave të ndryshme. Por e vërteta është ndryshe, se sipas hulumtimeve që kam bërë në arkivat e gjykatave të qarqeve në Kosovë të dhënat janë kokëforta dhe dëshmojnë një të vërtet tjetër.

Patjetër duhet theksuar se, në popullsinë e gjithëmbarshme të ish-Jugosllavisë shqiptarët merrnin pjesë me afro 12 për qind, kurse në numrin e përgjithshëm të të dënuarve politikë me mbi 90 për qind. Pra, vetëm në burgje shqiptaret ishin shumicë. Nga viti 1945-1990 u dënuan me burgim të rëndë mbi 9.220 (7.684+1536) persona, të cilëve iu shqiptuan mbi 66.672 vjet e 7 muaj burgim, apo shndërruar në shekuj shqiptarët gjatë regjimit të egër jugosllav u dënuan me 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burg. Sipas analizës së të dhënave, mesatarja e dënimeve me burgim që u ishin shqiptuar shqiptarëve për "vepra penale politike", ishte 7 vjet e 1 muaj. Nëse kjo mesatare e dënimeve shumëzohet për 3.348 veta, që ishin të dënuar brenda viteve 1981-1990, del se vetëm në këtë periudhë shqiptarëve u ishin shqiptuar rreth 23.770, vjet e 8 muaj burgim. Nëse këtij numri po ashtu ia shtojmë edhe rreth 1.232 vjet burgimi që u ishin shqiptuar rreth 10.000 shqiptarëve në procedurë kundërvajtëse, del se gjatë kësaj periudhe për vepra penale politike dhe për kundërvajtje politike ishin shqiptuar gjithsej 25.002, vjet e 8 muaj burgim. Në këtë periudhë gjithashtu u dënuan 1.346 ushtarë shqiptarë, ndërsa 63 u vranë në kazerma ushtarake. Vetëm gjatë vitit 1981, (sipas të dhënave arkivore), kuptohet pas 11 marsit, në mbarë Kosovën gjykatat e qarkut në Prish-tinë, në Gjilan, në Pejë, në Prizren dhe në Mitrovicë do të organizojnë mbi 36 procese gjyqësore politike në të cilat do të dënohen mbi 297 veta, me 1, 6 deri në 15 vjet burgim të rëndë. Nga policia prej marsit 1981 deri në tetor 1989 u trajtuan 584.373 shqiptarë. Ndaj tyre u përdor dhuna prej kërcënimeve deri në

rrahje të shkallës së humbjes së vetëdijes, apo deri në mbytyje të personit e rastet e tilla nuk ishin të rralla. Ndërsa nga viti 1945-1990 u dënuan me pushkatim 202 veta, ndërsa u likuiduan mbi 752 veta. Do theksuar se edhe brenda organizatave politike të kohës kishte dallime rreth artikullimit programor, se cila ishte platforma më e mundshme dhe më e përshtatshme që duhej të përdorej për rrethanat e kohës, për të ardhur deri te një strategji e përbashkët veprimi. Dallimet konsistonin në atë se si duhej t'i qaseshin zgjidhjes së çështjes kombëtare, ngase veprimtaret e ilegales asnjëherë në qëndrimet e tyre nuk ishin dogmat, por varësisht prej rrethanave kombëtare e ndërkombëtare, krijonin edhe qëndrimet e tyre. Këtë të dhënë, më së miri e dëshmon evoluimi i qëndrimeve rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës në situata të caktuara, që do i paraqes, të përmbledhura në tre opsione si:

1. Bashkimi i të gjitha tokave shqiptare me Shqipërinë;
2. Bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare në një republikë brenda Jugosllavisë dhe
3. Republika e Kosovës.

Që të tri këto opsione të shtruar nga veprimtarët e ilegales të Lëvizjes Kombëtare, në periudha të ndryshme kohore, kishin edhe bartësit e vet ideor. Opsionin e parë për bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë në programin e saj e kishte paraparë LNDSh, Besa Kombëtare, Partia Revolucionare për Bashkimin e Trojeve Etnike me Shqipërinë" (1958); "Organizata për Bashkimin e Trojeve Shqiptare" (1959); "Komiteti për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë" (1960) „Grupi Revolucionar“, "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" (1963). OMLK e dhe Lëvizja Nationale për Çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Që të gjitha këto organizata ishin vazhdimësi e lëvizjeve ilegale për çlirim kombëtar qysh nga Lidhja e Prizrenit (1878) e këndej.

Opsionin e dytë e kishte paraparë organizata "Partia Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi", e cila në programin e saj parashihte bashkimin e të gjitha trojeve ku shtriheshin shqiptaret në një republikë në kuadër të RSFJ-së.

Opsioni i tretë, apo zanafilla e idesë për Republikën e Kosovës ishte shpalosur fillimisht me demonstratat e vitit 1968. Por si më e sforcuar u paraqit në formë të plotë, në periudhën e demonstratave të vitit 1981 e 1989. Kosova-Republikë, pas shumë

bisedimeve në mes të veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare ilegale, ishte kërkesë e të gjitha grupimeve ilegale pas vitit 1968, 1981, 1989, që më vonë do të bëhet kërkesë e gjithë popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera jugosllave të banuara me shqiptarë.

Mirëpo, pas ndryshimeve të shumta politike që pasuan në mes viteve 89-99 të shekullit të kaluar, veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që vepronin në ilegalitet, por edhe ata që vepronin në parti të ndryshme politike legale që u formuan gjatë kësaj periudhe, duke e par dhe hetuar ndikimin e faktorit të brendshëm dhe të atij ndërkombëtarë, në qëndrimet e veta filluan të bënin korrigjime në qasje dhe në organizim.

Programet politike e kombëtare dhe mjetet e format e luftës me të cilat parashihej të arriheshin qëllimet e saja, në esencë, kishin mbetur të pandryshueshme gjatë gjithë historisë së lëvizjes kombëtare. Por, forma më e lartë e rezistencës, lufta e armatosur, ndonëse ishte pjesë e programeve, por edhe e praktikës historike të lëvizjes kombëtare, arriti të zbatohet në tërë kuptimin dhe gjerësinë e saj, vetëm në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, atëherë kur u krijuan kushtet e brendshme dhe të jashtme për të, kur u poqën faktorët subjektivë dhe objektivë të lëvizjes. Brezat e mëparshëm të lëvizjes ilegale, nuk mund ta bënin këtë, në Jugosllavinë stabile e me prestigj ndërkombëtar dhe në rrethanat e luftës së ftohtë. Megjithatë, lufta çlirimtare përgatitej dhe zhvillohej shkallë-shkallë përballë valëve të egra të dhunës që ushtronte pushtuesi.

Ky besim dhe ky angazhim i pa kursyer i ilegales dhe besimi i madh në popullin e vet, ndikoi që të formohej edhe UÇK-ja, ngase çdo organizatë shqiptare ilegale në ish Jugosllavi, në programet e tyre, përveç zgjidhjes paqësore të çështjes shqiptare, ato parashihnin edhe zgjidhjen me luftë. Andaj, dalja në skenë e UÇK-së nuk ishte e rastësishme dhe se ishte krahu më i natyreshëm i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë që nga viti 1945. Lufta e Kosovës nën udhëheqjen e UÇK-së, dhe ndihma e madhe nga faktori ndërkombëtar që sollën lirin që ne sot e gëzojmë, dëshmon dhe provon se ishte vepra më madhore e të gjithë atdhetarëve që u angazhuan për Pavarësinë e saj duke mos kursyer as jetën e tyre.

\*Fusnotat janë hequr nga redaksia



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Ramadani dhe Krasniqi: Duhet të jemi të kujdesshëm në Norvegji



**PRISHTINË, 6 GUSHT** - FC Prishtina e fitoi ndeshjen e parë kundër Bodo/Glimt (2-1) në kuadër të rrethit të tretë të Ligës së Konferencës. Trajneri Zekirija Ramadani dhe futbollisti Besnik Krasniqi janë shfaqur të kënaqur me fitoren e arritur në stadiumin "Fadil Vokrri", por kanë kërkuar që në ndeshjen e kthyesë në Norvegji të jenë me të kujdesshëm. "Nuk dua të kemi eufori.

Duhet edhe atje të jemi më të kujdesshëm në mbrojtje dhe besoj se do të kemi mundësi. Unë mendoj që nëse luajmë me disiplinë taktike në fazën defensiva, do ta na jepet mundësia të shënojmë edhe atje", ka thënë Ramadani.

Në linjë të njëjtë me trajnerin është edhe mbrojtësi i djathtë, Besnik Krasniqi. "Fitorja në ndeshjen e parë na jep shpresë, por nuk duhet të

kënaqemi me kaq sepse ata janë tejet të fortë. Në fillim u ndëshkuam nga gabimi që bëmë. Ne duhet të jemi më të vëmendshëm në ndeshjen e ardhshme ndaj tyre. Por, pas gabimit ne morëm lojën nën kontroll dhe shënuam dy herë për ta fituar ndeshjen", ka thënë Krasniqi. Ndeshja kthyesë mes Bodo/Glimt dhe Prishtinës zhvillohet pas një jave në Norvegji.

## SHKURT

### Latif Demolli zgjedhet sekretar i përgjithshëm i FboxK-së

Latif Demolli është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i Federatës së Boksit të Kosovës (FboxK). Demolli në këtë pozitë e zëvendëson Mehmet Bogujevcin, i cili ditë më parë doli në pension. "Më 5 gusht u mbajt mbledhja e rregullt e bordit të FboxK. Ndër pikat e rendit të ditës ishte edhe zgjedhja e sekretuarit të përgjithshëm të FboxK. Pas largimit të Mehmet Bogujevcit nga posti i sekretarit të FboxK, bordi unanimisht zgjodhi Latif Demollin sekretar të përgjithshëm", thuhet në njoftimin e FboxK-së.

### Faqja kryesore e Olimpiadës rikujton suksesin e Distria Krasniqit

Distria Krasniqi është përkujdesur që t'ia sjellë Kosovës medaljen e parë të artë nga Lojërat Olimpikë 'Tokio 2020'. Xhuditja e Kosovës pati një paraqitje të jashtëzakonshme në Olimpiadë, derisa fitoi të artën deri në 48 kilogramë. Por kur kanë kaluar dy javë nga sukcesi i xhuditës kosovare, faqja kryesore e Lojërave Olimpikë është përkujdesur që ta na rikthejë ato emocione. Kjo faqe ka postuar një foto të Distrias së emocionuar pas fitimit të medaljes së artë. "Emocionet që ju doni të shihni", ka shkruar faqja zyrtare e Olimpiadës. Gjithsesi nuk ishte vetëm Distria Krasniqi që fitoi të artën, pasi suksesin e saj për Kosovën e përsëriti edhe Nora Gjakova.

### Kosova përballë Andorrës në gjysmëfinale


Kosova U18 po zhvillon një kampionat mjaft të mirë në FIBA European Challenger, që po zhvillohet në Tiranë. Dardanët e rinj shënuan fitore ndaj Shqipërisë 85:62 dhe ndaj Moldavisë 45:108, duke qenë liderë të Grupit F me dy fitore në dy ndeshje të zhvilluara. Kosova në gjysmëfinale do të përballë me Andorrën, takim që do të zhvillohet të shtunën nga ora 16:00 në Tiranë. Andorrasit u renditen në vendin e dytë në Grupin G, me dy fitore dhe një humbje. Andorra mundi Gjibraltarin 62:51 dhe Maltën 57:75, kurse pësoi nga Luksemburgu 71:68. Gjysmëfinalja tjetër zhvillohet mes Luksemburgut dhe Shqipërisë, të shtunën nga ora 19:00. Turneu përfundon të dielën, ku do të zhvillohet finalja, ndeshja për vendin e tretë dhe për pozitën 5-7.

## Liga Unike edhe te femrat

**PRISHTINË, 6 GUSHT** - Liga Unike pritet që të jetë mjaft interesante në edicionin e ri me skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria. Këtë edicion risi do të jetë edhe fillimi i garave në konkurrencën e femrave. Në edicionin garues 2021/2022 do të garojnë nga tri skuadra nga Shqipëria dhe tri skuadra nga Kosova të cilat do të luajnë në sistem të garave vajtjeardhje me 10 xhiro

të rregullta dhe "play-off". Klubet nominohen nga Federatat Nacionale. Para fillimit të kampionatit të Ligës Unike do të organizohet Superkupa Mbarëkombëtare në dy konkurrencat. Edicioni i rregullt 2021/2022 i Ligës Unike në dy konkurrencat të fillojë më 20/21 tetor 2021. Në edicionin e fundit, garat në konkurrencën e femrave në Kosovë ishin

mjaft interesante me katër skuadra që luftonin për titull, ndërkohë tri skuadra fituan nga një trofe. Bashkimi fitoi Superkupën, Prishtina fitoi Kupën dhe Penza u shpall kampione. Ndërkohë, në Shqipëri kampion u shpall Flamurtari, duke mundur Partizanin 3:0 në serinë finale, ndërkohë Kupën e fitoi Partizani duke mundur në finale Flamurtarin 89:85.





## Kryetari Lladrovci pret në takim vrapuesin e shtigjeve të gjata Erzen Zyberaj

DRENAS, 6 GUSHT - Kryetari i Komunës së Drenasit të premtën ka pritur në takim sportistin e vrapimeve të gjata, Erzen Zyberaj, i cili ka filluar kampanjën e vrapimit para disa ditësh për të vrapuar në gjithë Kosovën,

përkatësisht në 28 komuna me vrapim ditor 21 kilometra në ditë, në secilën komunë. Vrapimi i Erzen Zyberajt ka nisur me moton "Për Kosovën". Kryetari Ramiz Lladrovci ka përgëzuar vrapuesin Erzen

Zyberaj për këtë iniciativë të vrapimit në komunat e Kosovës dhe ka uruar që shembulli i Erzenit të ndiqet edhe nga të rinjtë tjerë për t'u marrë me aktivitete sportive. Në Drenas kampanjës së Erzenit

për vrapim në 21 kilometra i janë bashkëngjitur edhe Arta Krasniqi, mbesa e heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci, si dhe dy pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës nga Drenasi, Rafet Gashi dhe Lorik Rama.



# Laporta: Ndarja me Messin ishte zgjedhja e vetme



BARCELONË, 6 GUSHT - Joan Laporta ishte optimist gjatë gjithë kohës, por në fund nuk ia doli ta rinovojë kontratën me Leo Messin. Ylli argjentinas i dha fund aventurës 17-vjeçare në "Camp Nou", ndërsa presidenti i Barcelonës ka dalë në një konferencë për shtyp, aty ku flet rreth largimit të kapitenit argjentinas. "Nuk dua të krijoj shpresa të rreme. Ajo që është e sigurt është se lojtari ka oferta të tjera. Koha ishte e limituar si për ne dhe për Leon. Gjithçka tregon se ky 'fair-play financiar' do të vazhdojë të jetë aktiv. Do të donim që epoka post-Messi të niste pas dy vjetësh, jo tani. Ne të gjithë do të donim të vazhdonim të shijonim magjitë e tij, por nuk ishte e mundur. Kontrata pesëvjeçare që i ofruam? La Liga na sugjeroi bindshëm se kjo kontratë mund të pranohej, por pas një analize ata na treguan se nuk do të ishte e mundur", ka thënë Laporta. "Fatkeqësisht, ne kemi marrë një trashëgimi katastrofike: pagat e Barcelonës përfaqësojnë 110 % të fitimeve të klubit. Rregulloret e La Ligës kalojnë përmes fair-play

financiar që përcakton kufij. Kjo është arsyeja pse ne nuk ishim në gjendje ta respektonin marrëveshjen me Leo Messin. Për fat të mirë ne kemi një institucion 122-vjeçar që është mbi çdo lojtar, madje edhe lojtari më i mirë në botë. Ne do t'i jemi mirënjohës përjetësisht, por klubi është akoma gjëja më e rëndësishme. Do të vazhdojmë të fitojmë edhe pa Leon", ka shtuar Laporta.

### Barça ka një tjetër dedikim për Messin

Ndërkohë që të gjithë prisnin rinovimin, Leo Messi dhe Barcelona nuk ranë dakord për zgjatjen e bashkëpunimit mes tyre. Ylli argjentinas është larguar zyrtarisht nga ekipi i zemrës, aty ku ka mahnitur botën me futbollin dhe magjitë e tij. 34-vjeçari është lojtar i lirë, ai mund të zgjedhë pa probleme skuadrën e radhës që ka mundësi të jetë PSG. Barcelona ka postuar në faqen zyrtare një tjetër video dedikuar kapitenit legjendar. Imazhet tregojnë rritjen e

kampionit nga Rosario me fanellën e Barçës, ekip me të cilin debutoi në vitin 2005. "Nga një djalosh në më të madhin e historisë", shkruan klubi katalanas mbi video.

### Tifozët, Griezmannit: Ti je faktori për largimin e Messit

Lionel Messi nuk do të jetë më një futbollist i Barcelonës, por largimin e tij nuk do ta qajë vetëm klubi dhe populli katalanas, por edhe kampionati spanjoll. Ata që po e vuajnë më së shumti këtë largim janë tifozët e Barcelonës, të cilët nuk kanë ngurruar ta akuzojnë Antoine Griezmann si fajtor për largimin e "Pleshtit". Mediat spanjolle raportojnë se në qendrën stërvitore ishin mbledhur një numër i konsiderueshëm tifozësh, teksa kur mbërriti Griezmanni ata kanë shfryrë ndaj francezitet. "Ti je faktori për largimin e Messit", dëgjoheshin zëra nga tifozët e mërziut. Ndërkohë Barcelona po vijon stërvitjet, edhe pse në Katalunjë.

## SHKURT

### Gashi konfirmon largimin nga Dukagjini

Mesfushori i njohur Fatlum Gashi ka njoftuar se në edicionin e ri 2021/22 nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Dukagjinit. Futbollisti në fjalë ishte ndër më meritoret për rikthimin e skuadrës nga Klina në elitën e futbollit të Kosovës. "Ju njoftoj se nga sot nuk do të jem më pjesë e Klubit KF Dukagjini. Falënderoj klubin në krye me presidentin Fabian Veseli, bashkëlojtarët, stafin me të cilët kam punuar, kurse klubit i dëshiroj shumë suksese në vazhdim", ka shkruar Gashi në profilin e vet në "Facebook".

### Garcia thyen rekord olimpik

Ecësi spanjoll Jesus Angel Garcia vendosi një rekord në Lojërat Olimpikë, duke marrë pjesë në tetë Olimpiada. 51-vjeçari i lindur në vitin 1960 përfundoi sot i 35-ti në garën 50 kilometërshe, në Sapporo, raporton "Reuters". Spanjollit ka garuar në çdo Olimpiadë që nga ajo në Barcelonë më 1992 dhe ishte kampion bote më 1993.

### Meksika fiton medaljen e bronzit në 'Tokio 2020'

Meksika ka siguruar medaljen e bronzit në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" në futboll. Meksikanët ishin më të mirë gjatë gjithë takimit dhe nuk i lanë japonezët të bëjnë ndonjë befasi dhe e kontrolluan ndeshjen. Në pjesën e parë Meksika avancoi me dy gola të shënuara nga Cordova në minutën e 13 dhe nga Vasquez në minutën e 22. Në pjesën e dytë Vega shënoi golin e tretë për Meksikën në minutën e 58 për t'ia dhënë goditjen përfundimtare Japonisë. Japonëzët arritën ta shënojnë golin e nderit përmes Mitomas në minutën e 78 të takimit. Rezultati përfundimtar, Meksika 3-1 Japonia. Meksika fiton medaljen e bronzit.

### Maccabi Tel Aviv bën ofertë për Manajn

Në skenë për Rey Manajn del një klub i ri. Mediat katalanase, më konkretisht "Sport.es" bën me dije se në drejtim të Barcelonës ka mbërritur një ofertë nga Maccabi Tel Aviv me izraelitët që kanë ofruar 1,5 milion euro për gjysmën e kartonit të sulmuesit të kombëtares shqiptare. Një ofertë që gjithsesi nuk ka tunduar Barcelonën e cila është e pavendosur se çfarë do të bëjë me Manajn, ndërkohë që ofertat në drejtim të tij nuk mungojnë. Përveç Sassuolo dhe Venezias nga Seria A dhe Real Betis e Granadas në La Liga, për Rey Manaj ka shfaqur interesim edhe klubi kazak i Aktobes që është gati ta bindë Barcelonën me një ofertë të majme ekonomike.

## Nëse Lukaku largohet, Interi e transferon Zapatan

Duvan Zapata shihet si zëvendësuesi ideal i Romelu Lukakut. Romelu Lukaku po lidhet me një kalim te Chelsea për një shumë rekord prej 120 milionë eurosh. Mirëpo,

sipas "Corriere dello Sport", Interi tashmë e ka caktuar objektivin e tij për zëvendësimin e belgut. Opsionet të cilat ishin më të mirat për drejtuesit "Nerazzurri" ishin Zapata,

Vlahović dhe Dzeko. Artikulli sugjeron që Dzeko dhe Vlahović janë prapa Zapatas, pasi kolumbiani pëlqehet për cilësitë e tij të përafërta me Lukakun. Raportet e Zhang

me "La Dean" janë të mira dhe Atalanta po kërkon ta sjellë Tammy Abraham, gjë që është një lloj indikator se ata po kërkojnë zëvendësimin e Zapatas.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “SD Trading” SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NB: 810149840, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SD Trading” D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom BB: 810149840 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all clients that “SD Trading”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with NB: 810149840, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

“Epoka e re”

Prishtinë, 06.08.2021

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “BuleSing” SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NB: 811504027, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BuleSing” D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom BB: 811504027 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all clients that “BuleSing”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with NB: 811504027, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

“Epoka e re”

Prishtinë, 06.08.2021

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P ” Hysni Zajmi” Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

► “DEPO STEEL” Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.

► Fjolla Duraku nga gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”.

► Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

